



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 168, datë 27.7.2006

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRMINISTROR TË PUNËS,
PËRGJEGJËS PËR PËRGATITJEN, HARTIMIN DHE NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË
PËRFSHIRJES SOCIALE, NË KUADËR TË STRATEGJISË
KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë, “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri””,

U R D H Ë R O J :


1. Ngritjen e grupit ndërministror të punës, përgjegjës për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të përfshirjes sociale.
2. Ky grup të kryesohet nga ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës;
 - zëvendësministrin e Shëndetësisë;
 - Zëvendësministrin e Brendshëm;
 - Zëvendësministrin e Drejtësisë;

- Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
 - Zëvendësministrin e Financave;
 - Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Në mbledhjet e grupit të punës, në varësi të çështjeve, që do të diskutohen thirren të marrin pjesë:
- titullarët e institucioneve në varësi të ministrive pjesëmarrëse, që do të përfshihen ne përgatitjen dhe hartimin e strategjisë së përfshirjes sociale;
 - përfaqësues nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndihmës së Huaj;
 - ekspertë të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Integrimit.
4. Sekretari i Përgjithshëm ose njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta vepron si koordinator ndërmjet këtij grapi pune dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndihmës së Huaj, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integrimit.
5. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ngarkon me detyrën e sekretariatit teknik punonjësin ose njësinë, që siguron mbështetje, teknike dhe logjistike, për grupin ndërministror te punës.
6. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me propozimin e grupit ndërministror të punës, krijon një grup teknik pune, me ekspertë në nivel drejtori ose specialistësh të lartë, nga ministritë pjesëmarrëse, të kryesuar nga zëvendësministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
7. Për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të përfshirjes sociale zbatohen udhëzimet e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri, dhe manuali “Për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, strategjive, sektoriale dhe ndërsektoriale”, që i bashkëlidhet urdhrit nr. 134, datë 12.6.2006, të Kryeministrit.

8. Funksioni, rregullat e funksionimit dhe detyrat e grupit ndërministror të punës dhe të grupit teknik përcaktohen nga ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në përputhje me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
9. Ngarkohet ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Sali Berisha". Below the signature, the name "SALI BERISHA" is printed in a bold, capitalised sans-serif font.